

## Zhvillohet takimi dypalësh në kuadër të përgatitjeve për takimin e gjashtë ndërqeveritar Shqipëri-Kosovë "G2G 6" e gjashtë ndërqeveritar Shqipëri-Kosovë "G2G 6"



Në Prishtinë u zhvillua takimi dypalësh në kuadër të përgatitjeve për takimin e gjashtë ndërqeveritar Shqipëri-Kosovë "G2G 6". Agjencia Kombëtare e Diasporës përfaqësohet në këtë takim me z. Dritan Delija, Drejtor i Drejtorisë së Diasporës. Gjatë takimit u diskutua çështje të ndryshme të bashkëpunimit si dhe projekt-marrëveshje dhe protokolle bashkëpunimi ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës.

## Qendra e Botimeve për Diasporën vazhdon me dërgimin e teksteve mësimore falas në Diasporë



Vijojnë dërgesat e teksteve mësimore falas në Diasporë, nga Qendra e Botimeve për Diasporën. 10715 tekste mësimore të dërguara falas në 18 shtete të botës, për mësimin e gjuhës e kulturës shqiptare në Diasporë. Mbi 17 mijë tekste shkollore dhe plotësuese do të mbërrijnë brenda muajit shtator te nxënësit dhe mësuesit e shkollave të gjuhës dhe kulturës shqiptare të 22 vendeve të botës, për vitin 2020-2021. Stafi i QBD-së vijon punën për përcjelljen e tyre në vendin dhe kohën e duhur.

## QBD / Përrallat "Piter Pani" dhe "Bukuroshja e fjetur", tashmë vijnë në botimin dygjuhësh Shqip - Anglisht dhe Shqip-Greqisht si pjesë e serisë "Klasikët Dygjuhësh"



Përrallat shumë të dashura për fëmijët "Piter Pani" dhe "Bukuroshja e fjetur", tashmë vijnë në botimet dygjuhëshe shqip-anglisht dhe shqip-greqisht, si pjesë e serisë "Klasikët Dygjuhësh" - projekt i Qendrës së Botimeve për Diasporën. Vëllimet, sjellë në shqip nga Parid Teferiçi dhe në greqisht nga Maklena Nika, janë të pajisur me ilustrime shumë të këndshme, tekst të thjeshtë dhe me fjalët më të përdorshme në dy gjuhë që lehtësojnë mësimin e gjuhës në mënyrë argëtuese. Kjo seri shumë e dobishme, e mirëpritur dhe e përhëndetur nga shqiptarët e Diasporës, përfshin përrallat më të bukura, botuar në një vëllim dygjuhësh, dhe synon t'u vijë në ndihmë fëmijëve shqiptarë të rritur në mërgatë që gjuhën shqipe e mësojnë paralelisht me gjuhën e vendit, apo si gjuhë të dytë. Botimet dygjuhëshe, shqip-anglisht dhe shqip-greqisht "Piter Pani" dhe "Bukuroshja e fjetur", janë falas për fëmijët shqiptarë të Diasporës dhe falas në versionin online për të gjithë.

## Drejtoresha Ekzekutive e QSPA-së zhvillon takim zyrtar me ambasadorin Fabrizio Bucci

Në mjediset e Ambasadës italiane në Tiranë u zhvillua takimi zyrtar mes drejtoreshës ekzekutive të QSPA-së, Prof. Diana Kastrati dhe ambasadorit italian në vendin tonë, SH.T.Z. Fabrizio Bucci. Në qendër të takimit ishte prezantimi i veprimtarisë së punës së Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe shqyrtimi në terma konkretë i mundësive për bashkëpunim ndërinstitucional. Ambasadori Fabrizio Bucci shprehu interesimin e posaçëm dhe vullnetin pozitiv për të mbështetur projektet studimore dhe shkencore të QSPA-së.



## Shtyhen punimet e Kuvendit të parë Diturak të QSPA-së



Shtyhen punimet e Kuvendit të parë Diturak të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA). Situata e pandemisë ka diktuar që organizimi i këtij Kuvendi të shtyhet në prag të Festës së Pavarësisë, më datat 25-26 nëntor 2020. Tema e Kuvendit është "Gjendja aktuale e studimeve arbëreshe", dhe ky tubim mëton të nxjerrë në pah arritjet e deritanishme në lëvizjet e ndryshëm të studimeve mbi universin arbëresh si në studimet gjuhësore, studimet letrare, etnografike, antropologjike kulturore, të çështjeve juridike që lidhen me statusin aktual të arbëreshes si dhe, të përpunojë një strategji pune të përbashkët me të gjitha forcat studiuuese në të gjitha trevat shqiptolëse, por po aq edhe të gjithë albanologëve të huaj që kanë pasur e kanë në vëmendjen e tyre çështjen e Arbërisë.

## Vota e Diasporës Shqiptare



Të interesuarit për të drejtën e votes në migracion, mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore [këtu](#).

## "Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës"



"Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës" është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetimin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale të ndryshme në diasporë.

## Platforma Digjitale e Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për here të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

## Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"

SHKARKO APLIKACIONIN FALAS



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

## "Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):